



FUQIZIMI I ROLIT TË GRAVE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES!

Kjo broshurë është pregatitur në kuadër të projektit "Fuqizimi i rolit të grave në procesin e vendimmarrjes", zbatuar nga **Fondacioni Qendra Europiane** dhe mbështetur nga **Fondacioni Konrad Adenauer**, zyra për Shqipërinë.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

**Fondacioni
Qendra Europiane**

Rr. Vaso Pasha
P. 20, Ap. 57
Tiranë, Shqipëri
Tel: + 355 4 451 9076
www.euro-centre.eu

**Fondacioni
Konrad Adenauer**

Blv. Dëshmorët e Kombit
Kulla Binjake 1, K. 11, Ap. 3
Tiranë, Shqipëri
Tel: + 355 4 22 66525
www.kas.de/albanien

Botues:

ISBN:

Desing & Layout: Dritan Lleshi

PËRMBAJTJA

<i>A e dini se?</i>	4
<i>Shkurtime</i>	7
I. Në vend të hyrjes	9
II. Nocionet bazë	13
III. Kuadri ndërkombëtar	17
3.1 Historik: E drejta e votës	
3.2 E drejta e votës si standard i së drejtës ndërkombëtare	
IV. Kuadri ligjor vendas	25
4.1 E drejta e votës në këndvështrimin historik në Shqipëri	
4.2 E drejta e votës në kuadrin ligjor vendas	
V. Si mund të përfshihen gratë në vendimmarrje	31
5.1 Rëndësia e pjesëmarrjes së grave në procesin e vendimmarrjes	
5.2 Shmangia e fenomenit të “votimit familjar”	
VI. Në vend të mbylljes	36
<i>Bibliografi</i>	38

A E DINI SE...

- ◆ Termi "**demokraci**" ka lindur për herë të parë në qytetshetin e Athinës së lashtë.
- ◆ **Klisteni** njihet si babai i demokracisë athinase, e cila konsiderohet si demokracia e parë në historinë e njerëzimit (508-507 p.k).
- ◆ **Demokratizimi** është tranzicioni drejt një regjimi demokratik politik, duke përfshirë ndryshime politike thelbësore drejt demokracisë. Rezultati ideal i demokratizimit është t'i sigurojë qytetarëve të drejtën për të votuar dhe të drejtën për të pasur një zë në sistemin e tyre politik.
- ◆ Sipas Samuel P. Huntington, **valët e demokracisë** kanë qenë: **Vala e parë** "e ngadaltë" e shekullit XIX; **Vala e dytë** ka qenë pas Luftës së Dytë Botërore, dekolonizimi i vendeve aziatike dhe afrikane; **Vala e tretë** e demokracisë ka nisur në mes të viteve 1970 në Evropën Jugore, e ndjekur nga Amerika Latine dhe Azia; **Vala e katërt**, rrëzimi i murit të Berlinit 1989 dhe shembja e komunizmit. Shkolla të tjera si Seva Gunitsky e Universitetit të Torontos, referon se ka 13 valë nga shekulli i XVIII deri në Pranverën Arabe (2011 - 2012).

- ◆ Termi **feminizëm** ka të bëjë me lëvizjet politike, kulturore dhe ekonomike që kanë për qëllim të përcaktojnë të drejta të barabarta dhe mbrojtje ligjore për gratë. Valët e feminizmit janë: **Vala e parë** - 1830 deri në fillim të 1900, e cila ka qenë më tepër e lidhur me të drejtën e grave për të votuar; **Vala e dytë** ka qenë mes 1960 – 1980 dhe ka pasur të bëjë me lëvizjen e grave për të drejta të barabarta ligjore dhe sociale; **Vala e tretë** ka qenë mes viteve 1990 dhe fillimi i 2000, një vazhdim i të dytës, e lidhur me *“mikropolitikat”* dhe barazinë gjinore.
- ◆ **Republika e Korsikës** (në planin historik) konsiderohet si shteti i parë që njeh të drejtën universale për të votuar për të gjithë qytetarët mbi 25 vjeç, duke përfshirë edhe femrat.
- ◆ **Zelanda e Re**, përmes Ligjit për Zgjedhjet në 1893, njohu zyrtarisht të drejtën e përgjithshme të votës, përfshirë edhe femrat.
- ◆ **Dukati i Madh i Finlandës** (1096) njeh për herë të parë në Evropë të drejtën e votës për femrat dhe shtetasit pa tokë.
- ◆ **Në 1918**, në Britaninë e Madhe dhe Irlandë disa gra mbi moshën 30 vjeçare dhe burrat mbi moshën 21 vjeçare, fituan të drejtën për të votuar parashikuar në ligjin “Për Përfaqësimin e Popullit”.
- ◆ **Në 1928** të gjitha gratë mbi moshën 21 vjeçare, fituan të drejtën për të votuar si një të drejtë universale.

- ◆ **Në 1920**, thuhet në të gjitha vendet e Evropës Perëndimore dhe Amerikën e Veriut, njihet e drejta universale e meshkujve për të votuar.
- ◆ **Në 1930**, në Turqi u njoh e drejta e grave për të votuar për këshillat bashkiake dhe në 1934 ju njoh e drejta për të votuar në zgjedhjet e përgjithshme.
- ◆ **Në 1933** në Spanjë u njoh e drejta e votës së përgjithshme.
- ◆ **Në 2015**, grave në Arabinë Saudite ju njoh për herë të parë e drejta për të votuar.
- ◆ **Kanuni i Përshtshëm i Administratës Civile** ka qenë legjislacioni i parë për zgjedhjet në Shqipëri.
- ◆ **Statuti Organik i Shqipërisë** (në 1914) ka parashikuar për herë të parë të drejtën e votës.

SHKURTIME

- BE** Bashkimi Evropian
- DUDNJ** Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- GJEDNJ** Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- GJK** Gjykata Kushtetuese
- KEDNJ** Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- OKB** Organizata e Kombeve të Bashkuara
- OSBE** Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
- KQV** Komisioni i Qendrës së Votimit
- KQZ** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- KZ** Kodi Zgjedhor

WOMEN'S
RIGHTS ARE
HUMAN RIGHTS






I. NË VEND TË HYRJES

Trajtimi i së drejtës për zgjedhje të lira është i një rëndësie mjaft thelbësore, pasi aty nis dhe merr jetë pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje. Ajo përbën një gur themeli për shoqëritë demokratike dhe është një e drejtë që i garantohet çdo qytetari, me përjashtim të rasteve të cilat parashikohen në kushtetutat e shteteve, por jo vetëm. Garantimi i demokracive dhe mirëfunksionimi i shtetit të së drejtës bazohet në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Për këtë shteti Shqiptar ka ratifikuar mjaft Konventa, Pakte dhe Traktate dhe është anëtar i organizatave të ndryshme të cilat promovojnë demokracinë.

Duke u kthyer në retrospektivë, kjo e drejtë nuk gëzohej nga të gjithë njerëzit, madje në fillimet e hershme, ajo ju akordohej vetëm personave të cilët kishin pasuri, toka, i përkisnin një kaste të caktuar, shtetësie të caktuar, arsimimi, gjinie etj. Parimi i zgjedhjeve të përgjithsme (universale) ka evoluar dhe mund të themi që vetëm pas Luftës së II Botërore, me heqjen e një sërë kufizimesh për pjesëmarrjen në zgjedhje, mjaft persona që ishin të përjashtuar nga kjo e drejtë kanë mundur ta gëzojnë atë. Një ndër këto kategori ishin gratë, të cilat përmes lëvizjeve feministe që kanë nisur të marrin jetë në vitet 1830, kërkonin të drejta të barabarta, përfshirë këtu të drejtën e votës si dhe mbrojtjen ligjore të tyre. Falë këtyre lëvizjeve gratë arritën që të fitojnë të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Në Shqipëri janë bërë hapa pozitiv lidhur me përfaqësimin e grave në politikë, ku në zgjedhjet parlamentare të 2017, 28% e deputeteve ishin gra. Ky numër është tregues i rritjes së pjesëmarrjes së grave në politikë, por gjithësesi ato vijnë të jenë ende të nënpërfaqësuar. Referuar Indeksit Kombëtar të Pjesëmarrjes së Grave në Zgjedhje, i realizuar nga UN Women në 2017, në bazë të vlerësimit në nivel kombëtar pengesat në pjesëmarrjen e grave si votuese janë më të pakta, kuptueshmëria mbi fletën e votimit është më e madhe dhe menaxhimi i fushatës zgjedhore nuk ka nota shqetësuese. Nga ana tjetër, vihen re problematika të tilla si: presioni ndaj grave i ushtruar nga anëtarët e familjes, lidhur me cilin kandidat duhet të votojnë, besimi i tyre i lëkundur për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në politikë, për shkak të stereotiptit të krijuar se politika edhe nga vetë gratë koniderohet si një "punë

burrash". Një problematikë që evidentohet janë dhe kuotat gjinore, zbatimi i të cilave, mbetet ende i dobët. Dhe njëherësh stereotipet gjinore vijnë të mbeten shqetësuese duke luajtur një rol negativ në bërjen përpara të mjaft grave të cilat kanë vullnetin, potencialin dhe mundësinë për të kontribuar në jetën politike dhe jo vetëm.



Kjo broshurë vjen në kuadër të zgjedhjeve vendore që do të realizohen këtë qershor, në të cilat, fakti i përfaqësimit të grave në politikë nuk duhet të lidhet vetëm me plotësimin e kuotave gjinore, që për hir të së vërtetës është një detyrim ligjor, por me mbështetjen e duhur dhe pranimin e tyre nga shoqëria si profesioniste.

Për këtë kërkohet bashkëpunimi dhe vullneti i mirë i të gjithë aktorëve dhe është mjaft e rëndësishme dhe e nevojshme përmirësimi njohurive lidhur me standardet ndërkombëtare për të drejtën e votës, e cila është thelbësore në mirë adresimin e nevojave, problematikave dhe sfidave që hasen në kuadër të kësaj të drejte politike të garantuar në aktin themeltar të çdo shteti.



“Një botë me të vërtetë e barabartë do të ishte ajo ku gratë do të drejtonin gjysmën e vendeve dhe kompanive tona dhe burrat do të drejtonin gjysmën e shtëpive tona.”

SHERYL SANDBERG (LEAN IN)

II. NOCIONET BAZË

- ◆ **E drejta** është një synim, kërkesë, nevojë ligjore, morale apo shoqërore e cila ju njihet njerëzve nga organet qeverisëse. E drejta duhet të njihet dhe të respektohet nga të tretët, si dhe në rast se të njihet nuk mund të të mohohet më pas.
- ◆ **E drejta e votës** është një nga të drejtat themelore politike që çdo individ gëzon. Të gjithë qytetarët në moshë të rritur kanë të drejtë të votojnë dhe të votohen pavarësisht pasurisë, seksit, racës, gjuhës, fesë, mendimeve politike, origjinës kombëtare apo shoqërore, përkatësisë në një minoritet kombëtar etj., e drejtë kjo e përjashtuar vetëm disa raste sipas parashikimeve kushtetuese të çdo shteti.

- ◆ **Barazia gjinore**, e cila njihet edhe si barazia seksuale, është pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe e meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozita e barabartë ndërmjet tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar njëjloj nga arritjet e zhvillimit të saj.
- ◆ **Aktivizmi i të rinjve** konsiderohet si pjesëmarrje dhe përfshirje vullnetare në komunitet vetë ose përmes forumeve dhe organizatave të shoqërisë civile.
- ◆ **Pjesëmarrja në vendimmarrje** nënkupton angazhimin aktiv dhe ndonjëherë ligjor të qytetarëve në proceset nga të cilat merren vendime që ndikojnë në jetën e tyre dhe të komunitetit. Për të qenë aktiv dhe pjesëmarrës në jetën publike, përveç marrjes pjesë në votim, duhet që qytetarët të informohen, të vëzhgojnë sesi të zgjedhurit e përdorin pushtetin dhe marrin vendime, duke ndjekur mbledhje, takime, tryeza, si dhe të bëhen pjesë e iniciativave që synojnë të rrisin përgjegjshmërinë dhe frytshmërinë e autoriteteve vendase.
- ◆ **Kuota gjinore** është një masë me karakter të përkohshëm, e cila përdoret për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor dhe rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në jetën sociale, ekonomike e politike të një vendi.

- ◆ **Parimi i votimit të përgjithshëm mashkullor** nuk aplikohet më që pas Luftës së Dytë Botërore, kur edhe grave i'u siguroa e drejta e votës. Sipas këtij parimi, të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur e gëzonin vetëm burrat, duke patur kufizime në lidhje me moshën dhe statusin.
- ◆ **Votimi familjar** është një fenomen, i cili mund të shfaqet në dy forma: presion brenda anëtarëve të familjes, kryesisht ndaj grave dhe të rinjve për të votuar sipas kërkesës së kryefamiljarit, ose votimi faktik në kutinë e votimit nga ana e një anëtari të familjes, kryesisht kryefamiljarit, për të gjithë familjen.
- ◆ **Barazia e votës** është një nga parimet bazë të zgjedhjeve dhe bazohet në parimin e barazisë së shtetasve para ligjit. Kërkesa kryesore e këtij parimi është *një njeri, një votë*, dhe se vota e çdo shtetasi ka vlerë të barabartë.
- ◆ **Vota fakultative** është një nga tiparet e votës, sipas së cilës zgjedhësi nuk ka detyrime juridike për të votuar dhe nuk ka asnjë sanksion nëse ai abstenon nga kjo e drejtë. Detyrimi i vetëm në këtë aspekt është detyrimi moral.
- ◆ **Zgjedhje të lira**, është një term që përfaqëson një nga parimet bazë të zgjedhjeve dhe ka si kërkesë kryesore sigurimin e kushteve dhe garancive për të mundësuar shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve. Një nga elementët më thelbësorë të këtij parimi është *vota e fshehtë*.



WOMEN
of the
WORLD
UNITE

FREE
OUR
PANTHE
SISTERS
SOLIDARITY
Undergr...



III. KUADRI NDËRKOMBËTAR

3.1 Historik: Evoluimi i së drejtës së votës

Historik i shkurtër...

Në qytet-shtetin e Athinës së Lashtë konsiderohet se ka nisur forma e parë demokratike e ushtrimit popullor. Personat që kishin të drejtë të votonin ishin meshkujt e moshës 18 vjeç, të cilët merrnin pjesë në Mbledhjet e Asamblesë (Eleksia) gjithsesi demokracia në Athinën e Lashtë, ishte një demokraci e pakicës skllavopronare, ku në Kuvend apo organe të tjera të asaj kohe femrat brazoheshin me skllëvërit dhe të huajt, duke mos u përfshirë në vendimmarrje. Në qytet-shtetin e gadishullin Apenin, Romë, u krijua një formë organizimi e quajtur *Respublika*, ku të drejtën e votës e gezonte çdo mashkull i lindur romak, kur arrinte moshën madhore, por që gjithashtu



zotëronin pasuri, toka ose i përkisnin një kaste të caktuar. Nga kjo e drejtë ishin të përjashtuar të huajt dhe gratë, të cilat nuk kishin as të drejta të tjera në jetën politike. Në Perandorinë Romake të Lindjes (Bizanti), e drejta e votës thuhet se nuk ka ekzistuar fare. Në këtë periudhë ka pasur disa procedura për zgjedhjen e vendimmarrësve të tillë, si Perandori i Shenjtë Roman dhe Papa, të cilët zgjidheshin nga ushtria dhe senati, megjithëse në shumicën e rasteve ishin perandorët që zgjidhnin trashëgimtarin e tyre.

Zgjedhjet moderne të zyrtarëve publikë morën jetë në Amerikën e Veriut dhe në Evropë në shekullin e XVII. Kjo e drejtë erdhi si rezultat i revolucioneve demokratike të shekullit XVIII dhe XIX. Republika e Korsikës konsiderohet si shteti i parë që ka njohur të drejtën e votës në planin historik, megjithatë njohja zyrtare e të drejtës universale të votës, në të cilën janë përfshirë dhe femrat është në Zelandën e Re. Në Evropë e drejta e votës për femra u njoh në 1906 në Dukatin e Madh të Finlandës. Në vitin 1920 thuhet se të gjitha vendet në Evropën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut njihnin të drejtën universale të meshkujve për të votuar.

3.2 E drejta e votës, si standard i së drejtës ndërkombëtare

E drejta për zgjedhje të lira është guri i themelit të çdo shoqërie demokratike. Për të garantuar demokracinë dhe funksionimin e shtetit të së drejtës zgjedhjet duhet të bazohen në standardet

ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut. Një nga traktatet më të rëndësishme ndërkombëtare që mbron të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e miratuar më 1950, e ratifikuar edhe nga Shqipëria më 2 tetor 1996. Kjo konventë parashikon tre nene të cilat kombinohen me njëra-tjetrën, duke garantuar të drejta të tilla si barazia dhe mosdiskriminimi.

Në **nenin 3 të Protokollit 1** të Konventës parashikohet e drejta për zgjedhje të lira, e cila përfshin në vetvete barazinë përpara ligjit zgjedhor, ku të gjithë qytetarët kanë të drejtë të votojnë dhe të drejtë për t'u përfaqësuar në zgjedhje. Zbatimi i ligjit zgjedhor nuk duhet të jetë diskriminues, pasi gjithkujt duhet t'i garantohet gëzimi i të drejtave dhe lirive pa asnjë dallim bazuar në shkaqe të tilla si seksi [...] (Neni 14 i KEDNJ). Gjithashtu, në Protokollin 12 të Konventës parashikohet ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit, duke e zgjeruar më shumë konceptin e diskriminimit, dhe duke garantuar se askush nuk duhet të diskriminohet për ndonjë arsye nga një autoritet publik.

Në **Kodin e Komisionit të Vencias për Praktikën e Mira Elektorale**, ndër të tjera citohet se: "Trashëgimia evropiane, në fushën elektorale udhëhiqet nga pesë parime: ato duhet të jenë universale, të barabarta, të lira, të fshehta dhe të drejtëpërdrejta", që do të thotë se çdo sistem zgjedhor duhet të funksionojë në bazë të këtyre parimeve.


Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, midis shumë garancish të tjera në aktin themelor të OKB-së, **Deklaratën**

Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) e vitit 1948, në nenin 21 të saj përcaktohet qartë se kush ka të drejtë të marrë pjesë vetë në qeverisjen e vendit e të përfaqësohet nga personat e zgjedhur lirisht. Vullneti i gjithësecilit për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur arrihet përmes zgjedhjeve periodike dhe të lira. Sipas Kombeve të Bashkuara, nuk mund të ketë të drejta pa përgjegjësi, pasi kjo mund të derivojë në shkeljen e të drejtave të të tjerëve. Pra, kjo e drejtë nuk është absolute dhe shtetet palë gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi mbi të, të cilat duhet të mbështeten mbi arsyen juridike dhe vendimet e gjykatave të tyre për rastet përjashtimore.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

është një instrument i miratuar nga OKB-ja më 1966. Zbatimi i këtij pakti monitorohet nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut. Sipas tij, shtetet palë duhet të respektojnë të drejtat civile dhe politike të njeriut, ku ndër të drejtat themelore parashikohet dhe e drejta e zgjedhjeve. Sipas nenit 25, çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi për të drejtuar punët publike në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve të tjerë. Gjithashtu, në këtë nen parashikohet se gjithkush ka të drejtë të votojë dhe njëherësh të votohet në periudhën kur mbahen zgjedhjet elektorale vendore apo qendrore, kur zbatohen parimet e votimit të përgjithshëm, të barabartë dhe të fshehtë, të cilat garantojnë shprehjen e vullnetit të lirë të qytetarëve që votojnë. Gjithashtu në paragrafin e tretë të këtij neni, parashikohet pranimi i atyre që zgjidhen në kushte barazie, për të ushtruar funksionet e tyre publike, sipas garancive që ju jep ligji.

Gjithashtu, një instrument tjetër i rëndësishëm ndërkombëtar i miratuar nga OKB-ja ,është **Konventa për Eleminimin e të Gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave** (CEDAW) e vitit 1979. Në nenin 7 të saj, kjo Konventë parashikon se, të gjitha grave duhet t'u grantohen dhe eliminohen të gjitha format e diskriminimit, lidhur me te drejtën për të votuar dhe të drejtën për të qenë vetë ato të zgjedhura në mbajtjen e posteve publike dhe ushtrimin e funksioneve në të gjitha nivelet e qeverisjes.



"...partitë më të mëdha politike nuk i respektuan gjithmonë kuotat gjinore në listat e tyre të kandidatëve dhe pati një mbulim të paktë mediatik të grave kandidate... Gratë ishin të nënpërfaqësuar edhe në administratën zgjedhore, përfshirë pozicionet vendimmarrëse."

RAPORTI I OSBE/ODHIR LIDHUR ME ZGJEDHJET E KUVENDIT, TË 25 QERSHORIT 2017

OSBE/ODHIR është një organizatë rajonale për bashkëpunim dhe siguri në Evropë, e cila ka lujatur një rol kyç në vëzhgimin e zgjedhjeve elektorale në vend. Sipas raportit të fundit të OSBE/ODHIR lidhur me zgjedhjet e Kuvendit, të 25 qershorit 2017 *"Gratë ishin aktive, por të nënpërfaqësuar në fushatë. Disa prej aktiviteteve synuan në mënyrë të veçantë gratë zgjedhëse.*

TRATADO DE
LISBOA
PORTUGAL 2007



TRAKTATI I LISBONËS
13 DHJETOR 2007

Megjithatë, partitë më të mëdha politike nuk i respektuan gjithmonë kuotat gjinore në listat e tyre të kandidatëve dhe pati një mbulim të paktë mediatik të grave kandidate. Ndonëse rreth 40 % e kandidateve ishin gra, ato morën vetëm 27.9 % të vendeve në Kuvendin e ri. Gratë ishin të nënpërfaqësuar edhe në administratën zgjedhore, përfshirë pozicionet vendimmarrëse.”

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, e miratuar në vitin 2000, përmban një sërë të drejtash të cilat i përgjigjen vlerave evropiane. Kjo Kartë ka pasur një qasje të të drejtave të garantuara në kushtetutat e vendeve anëtare, KEDNJ-së dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, ky instrument filloi të ishte i detyrueshëm, pasi deri në 2009 ai nuk kishte fuqi juridike. Në nenet 39 dhe 40 të saj, parashikohet se çdo qytetar i Bashkimit Evropian ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në zgjedhjet për Parlamentin dhe në zgjedhjet vendore, sipas parashikimeve ligjore të shtetit të tij/saj anëtar. Edhe në këto nene parashikohet ushtrimi i drejtpërdrejtë dhe i përgjithshëm i votës së lirë dhe të fshehtë. Duke qenë se vendi ynë aspiron të bëhet pjesë e BE-së dhe me shpresë pritet hapja e negociatave këtë qershor, është mjaft e rëndësishme njohja me vlerat dhe standardet e BE-së. Të gjitha këto duhen pasur në vëmendje me qëllim edhe kryerjen e *“detyrave të shtëpisë”*, që Komisioni i BE-së i ka dhënë Shqipërisë në progres-raportin e fundit, në 2018. Si pjesë e kriterit politik, në këtë raport theksohet se zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2017 kanë qenë të qeta. Megjithatë duhen pasur në vëmendje rekomandimet e bëra nga OSBE/ODHIR, të cilat janë parashtruar më sipër në këtë dokument.



ARRESTIMI I NJË
MILITANTE E SË DREJTËS
SË VOTIMIT PËR GRA,
LONDËR, 1910-1915



IV. KUADRI LIGJOR VENDAS

4.1 E drejta e votës në këndvështrimin historik në Shqipëri

Historik i shkurtër...

Zgjedhjet e para parlamentare të Republikës së Shqipërisë, të zhvilluara në vitin 1920, u rregulluan me ligjin e 1920 "Për zgjedhje të deputetëve". Ky ligj, parashikonte votimin e përgjithshëm e të tërthortë, që ju garantohej vetëm meshkujve, duke përjashtuar në këtë mënyrë gratë nga e drejta për të votuar. Ky ligj, nuk përfaqësonte të gjitha shtresat e shoqërisë dhe për rrjedhojë ndryshimi i tij ishte i nevojshëm, duke marrë parasysh edhe mendimet e shprehura në veprat e juristëve të asaj kohe mbi zgjerimin e votimit, duke e lidhur të drejtën e votës gjithnjë e më shumë me parimet demokratike.

Shënjes në historinë e të drejtës shqiptare për të zgjedhur, ka qenë ligji i vitit 1925 “Për zgjedhjen e Dhomës së Deputetëve”, i cili bëri një kthesë të rëndësishme sa i takon zgjerimit të së drejtës së votës. E drejta për të votuar ju njoh çdo personi që kishtë mbushur moshën 18 vjeç dhe e drejta për t’u votuar çdo personi që ishte mbi moshën 25 vjeç. Gjithashtu, ky ligj rriti dhe normën e përfaqësimit dhe solli ndryshime në procesin e votimit, duke i’u përshtatur një shtrese më të gjerë të popullsisë që ishte analfabete. Megjithatë, edhe ky ligj vazhdoi të ndiqej nga parimi mashkullor, duke mos i garantuar grave të drejtën e votës.

Në Shqipëri, ashtu si edhe në shumicën e vendeve të tjera, gratë patën mundësi të votonin për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore. Sigurimi i së drejtës së votës lidhej me pjesëmarrjen aktive të grave në luftën kundër fashizmit, por edhe me klimën e përgjithshme në favor të grave që u krijua pas viteve 1945. Pra, fitimi i të drejtës së votës nga ana e grave erdhi në sajë të lëvizjeve të vazhdueshme dhe këmbënguljes së organizatave feministe në të gjitha vendet.

4.2 E drejta e votës në kuadrin ligjor vendas

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon si një nga parimet themelore të saj, sanksionuar në nenin 1 § 3, se qeverisja e saj do të bazohet në një sistem zgjedhjesh *të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike*.

Kushtetuta i kushton lirive dhe të drejtave politike një kapitull të veçantë në përmbajtjen e saj. Në nenin 45 të saj ajo garanton të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, e cila i njihet çdo shtetasi që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë dhe ditën e zgjedhjeve. Përrjashtim nga kjo e drejtë bëjnë shtetasit të cilëve ju është hequr zotësia juridike për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë (rasti i aftësive të kufizuara mendore). Gjithashtu, të dënuarit që vuajnë dënimin me heqje lirie, të cilët përjashtohen vetëm nga e drejta për t'u zgjedhur, por jo nga e drejta për të zgjedhur.

Për t'u theksuar është edhe pika 4 e këtij neni, në të cilën parashikohet parimi i *votes vetjake*. Më konkretisht, në Kushtetutë parashikohet se *"Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë"*. Për këtë është e rëndësishme të përcaktohen rregullat dhe procedurat që do të sigurojnë karakterin vetjak të votës, e cila plotësohet më tej në parashikimet e Kodit Zgjedhor.

Kodi Zgjedhor parashikon periodicitetin e zgjedhjeve qëndrore dhe vendore, të cilat do të kryhen një herë në katër vite, njëherësh në gjithë territorin e vendit". Data e zgjedhjeve përcaktohet me dekret të Presidentit dhe në pjesën e tretë të tij parashikohen rregullimet mbi zgjedhësit dhe listat e zgjedhësve, duke përcaktuar kriteret për t'u regjistruar si votues të tilla si moshë, shtetësia, zotësia juridike për të vepruar, etj. Vlen për t'u pasur në vëmendje pjesa e Votimit (Pjesa 9) në të cilën përcaktohen elementët e votimit si: përmbajtja e fletës së votimit, mënyra e votimit, e deri tek

dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe procesi i numërimit të votave. Lidhur me karakterin vetjak të votës, Kodi parashikon detyrimin e organeve kompetente për të bërë regjistrimin e saktë të zgjedhësve në listat zgjedhore, pajisjen me fletë votimi për çdo votues të identifikuar nga Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV), sigurimin e dhomës së fshehtë të votimit si dhe për të detyruar çdo votues që ta kryejë procesin e votimit vetëm në këtë dhomë, etj. Edhe për zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë Kodi ka parashikuar mënyrën e votimit (neni 108), ku një i afërm mund të votojë për personin që nuk mund të votojë vetë, vetëm pasi t'i jetë kërkuar paraprakisht kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, të jetë bërë regjistrimi i tyre si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë. Kjo kërkesë duhet shoqëruar me dokumentacionin zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e aftësisë së kufizuar. Personi për të cilin votohet duhet të jetë prezent gjatë votimit në dhomën e fshehtë.

Kodi Zgjedhor parashikon edhe zbatimin e kuotës gjinore në zgjedhje, ku parashikohen rregulla për përmbushjen e kuotës si në organet e zgjedhura qendrore, ashtu dhe në organet e zgjedhura vendore (neni 67 § 6).

- ◆ Për çdo zonë zgjedhore, 1 në 3 emrat e parë në listë duhet t'i përkasë secilës gjini.
- ◆ Për çdo Këshill Bashkie 1 në çdo 2 emra të njëpasnjëshëm, duhet t'i përkasë secilës gjini.

Përrjashtim! Në rastin e ndërprerjes së mandatit të deputetit ose anëtarit të Këshillit të Bashkisë, mandati i kalon kandidatit të parë në listë të gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë (neni 164 § 2).

Gjithashtu, në raste të mosrespektimit të barazisë gjinore parashikohen sanksione të cilat në rast mospërbushje subjekti dënohet nga KQZ-ja me gjobë në vlerën 1,000,000 lekë. Për zgjedhjet për Kuvendin, sanksioni plotësues është zëvendësimi i vendeve vakante në zonat ku nuk është plotësuar *kuota gjinore*. Për zgjedhjet vendore, sanksioni plotësues është refuzimi i listës së partisë politike të kandidatëve për këshillat bashkiakë.

Përveç Kodit, një parashikim lidhur me përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si një nga kërkesat kryesore të parimit të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në baza gjinore e bën **ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”**. Përfaqësimi duhet të shtrihet jo vetëm për punonjësit, por njëherësh dhe në organet drejtuese. Ashtu si në Kod parashikohen kuotat (30 % për secilën gjini) dhe për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor, si dhe rritja e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në jetën sociale, ekonomike e politike të vendit.



GJATË VOTIMIT NË
ZGJEDHJET LOKALE
NË NEW YORK CITY,
NËNTOR 1917

V. SI MUND TË PËRFSHIHEN GRATË NË VENDIMMARRJE

5.1 Rëndësia e pjesëmarrjes së grave në procesin e vendimmarrjes

Në bazë të studimeve dhe sondazheve të ndryshme gratë janë më pak të interesuara dhe shfaqin një nivel më të ulët aktivizmi në politikë sesa burrat. Ekziston një perceptim i përgjithshëm, përfshirë edhe gratë të cilat mendojnë se meshkujt janë lidera më të mirë në politikë. Pra, edhe pse përfshirja e femrave dhe të rinjve në bazë të kuotave gjinore sipas Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për barazinë gjinore ka pasur përmirësime, apo dhe në aspektin politik ka pasur një qasje korrekte, shqetësimi që ngrihet është pranimi që i bëhet nga ana e opinionit publik. Me gjithë përparimin që është bërë në aspektin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave në

procesin vendimmarrës, fatkeqësisht vazhdojmë të themi se ato mbeten të nënperfaqësuara, si në organet përfaqësuese, ashtu edhe në organet e administratës zgjedhore.

Konkretisht, në zgjedhjet qendrore të vitit 2017, nga 40 % (1073) të kandidatave gra, ato morën vetëm 27.9 % të vendeve në Kuvend. Qarku me rekorde gjinore ishte Dibra (50 %), e cila ndiqej nga Tirana (41 %) e më pas Durrësi me 36 %. Qarqet me përfaqësimin më të ulët ishin Berati dhe Elbasan (13 %). Edhe mbulimi mediatik për gratë kandidate në rang vendi ishte mjaft i ulët (13%).

Në zgjedhjet lokale të vitit 2015, ka pasur një rritje të pjesëmarrjes së grave në proceset vendimmarrëse. Megjithatë, numri i kandidatave gra për kryetare bashkie ka qenë mjaft i ulët, vetëm 10 % (16 në total). Ndërsa tek këshillat bashkiake janë respektuar kuotat gjinore (50%). Në lidhje me administratën zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhej nga 3 gra, një prej të cilave ishte dhe kryetarja, ndërsa në nivelet më të ulëta të komisioneve, gratë ishin të nënperfaqësuara. Hapësira mediatike, qartazi ka qenë më e ulët për gratë, më pak se 5%.

Për sa më sipër, vëzhgues vendas edhe ndërkombëtarë janë duke luajtur një rol mjaft të rëndësishëm, për arritjen e një ekuilibri mes gjinive në të gjitha hallkat e pushtetit, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor përfshi dhe shërbimet e sigurisë, të tilla si policia. Barazia gjinore në jetën politike dhe publike nuk është e nevojshme vetëm për përmirësimin e përfaqësimit, llogaridhënies dhe demokracisë, por ka ndikim thelbësor në mënyrën sesi hartohen politikat më tej. Në vendet ku gratë

janë më tepër të përfshira në proceset e politikëbërjes dhe ato legislative, adresimi i problematikave të tyre do të jetë më konkret. Me qëllim forcimin e pjesëmarrjes së tyre në jetën politike dhe publike duhen marrë një sërë hapash si:

- ◆ Identifikimi i problematikave, përmirësimi i ligjeve e politikave dhe promovimi i praktikave të mira të angazhimit të grave në vendimmarrje.
- ◆ Integrimi i tyre në jetën parlamentare, përmes sjelljes në vëmendje të çështjeve gjinore, duke ndikuar në forcimin e politikave e legjislacionit.
- ◆ Përfshirja e të gjithë aktorëve politikë me qëllim respektimin e kuotave gjinore, për të pasur një përfaqësim të drejtë mes burrave dhe grave në organet publike të zgjedhura.
- ◆ Forcimi i besimit të grave dhe opinionit publik në përgjithësi se ato mund të drejtojnë poste publike, të përfshihen në role vendimmarëse duke qenë të arsimuara, ndjekur programe të ndryshme trajnimi etj.
- ◆ Promovimi i institucioneve demokratike, gjithpërfshirëse, përfaqësuese dhe të vëmendshme ndaj çështjeve gjinore, në mënyrë që dhe grupeve të marginalizuara t’ju ofrohet akses në vendimmarrje.

5.2 Shmangia e fenomenit të “votimit familjar”

Një nga fenomenet që është ngritur me shqetësim si nga vëzhguesit vendas ashtu edhe ata ndërkombëtarë, ka qenë fenomeni i “*votimit familjar*”, kur kryesisht gratë dhe të rinjtë

kanë qenë dhe vijojnë të mbeten subjekt i këtyre presioneve për të votuar për kandidatë apo parti politike të caktuara apo për të mos votuar fare.

Një fenomen i tillë është më tepër i përhapur tek personat që kanë një nivel të ulët arsimor, i përkasin shtresave të varfra të popullsisë, të papunëve, grave të varura financiarisht nga familja apo bashkëshorti dhe që kryesisht jetojnë në zonat rurale dhe ato të thella. Por nga ana tjetër duke e parë pak më thellë, aty ku zë rrënjë dhe kjo problematikë, *“votimi familjar”* nis në shtëpi duke u konsideruar si një përfaqësim familjar, ku në diskutime të ndryshme, shpesh gratë apo të rinjtë i binden autoritetit mashkullor për kë parti apo kandidat duhet të votojnë. Gjithashtu, *“frika për të mos u hequr nga puna”* në rastet kur një familje ka të punësuar në administratë mund të jetë një faktor që çon në votimin familjar. Rastet më flagrante janë ato kur gratë shoqërohen nga në dhomat e votimit nga anëtarët e familjes në ditën e zgjedhjes. Megjithatë, referuar raporteve të OSBE/ODHIR (2009, 2011, 2013, 2017) ky fenomen ka shkuar drejt rënies.

Gjithashtu, gjatë periudhave të zgjedhjeve vihen re dhe fenomene të tilla si *“votimi për të mbajtur vendet e punës”* dhe *“për t’u punësuar pas zgjedhjeve”* apo presionet e ndryshme të bëra edhe në sektorin privat vijojnë të jenë prezente, të evidentuara në raportin e OSBE/ODHIR për zgjedhjet qendrore të 2017.

Disa mënyra përmes të cilave ky fenomen mund të luftohet janë:

- ◆ Informimi i qytetarëve lidhur me reduktimin e *“votimit familjar”* është mjaft i rëndësishëm dhe sidomos në zonat ku haset më shpesh, si zonat rurale, të thella etj.;
- ◆ Sensibilizimi i qytetarëve se vota shpreh vullnetin e tyre të lirë dhe vetjak nga ku merr jetë dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje.;
- ◆ Thyerja e stereotipeve të tilla, se gratë nuk janë të afta të marrin vendime politike apo nuk “janë për të bërë politikë” duhen luftuar përmes fushatave sensibilizuese dhe informacioneve të nevojshme lidhur me të drejtën e votës.;
- ◆ Mediat kanë një rol thelbësor në promovimin e votës vetjake dhe të lirë, duke paraqitur dhe sanksionet e parashikuara në rastet e *“votimit familjar”*.;
- ◆ Prezenca e vëzhguesve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, për të mos lejuar këtë fenomen, duke i tërhequr vëmendjen personave përgjegjës (qytetarët që votojnë apo zyrtarët e Qendrave të Votimit).
- ◆ Meritokracia në zgjedhjen e punonjësve të Administratës Publike me qëllim shmangien e presioneve për largim nga puna.

Për të arritur pjesëmarrjen e kërkuar të grave në vendimmarrje, për të luftuar fenomenet negative të sipërpërmendura, votimi në zgjedhje është një detyrë e rëndësishme qytetare. Po kaq e rëndësishme është edhe e drejta e tyre që të vijojnë të informohen mbi çështjet publike, të vëzhgojnë me kujdes sesi përdoret pushteti nga ana e drejtuese politikë dhe përfaqësuesit e tyre dhe më e rëndësishmja të shprehin mendimet e tyre për mënyrën dhe cilësinë e qeverisjes.



**ARRESTIMI I EMMELINE
PANKHURST, LIDERE E
LËVIZJES BRITANIKE PËR "TË
DREJTËN E VOTËS SË GRAVE"
21 MAJ 1914**

VI. NË VEND TË MBYLLJES

E drejta e votës, e drejta për t'u zgjedhur dhe e drejta për të pasur poste publike, janë të drejta të cilat gëzohen nga të gjithë njerëzit, me përjashtim të rasteve të cilat i parashtruan shkurtimeisht në këtë punim. Falë lëvizjeve feministe dhe përpjekjeve të vazhdueshme për thyerjen e stereotipeve gjinore, sot zëri i grave në botë, padiskutim që dëgjohet më shumë. Votimi në zgjedhje është një nga elementët më të rëndësishëm të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Vetëm përmes zbatimit të parimeve të së të drejtës për të

votuar të tilla si parimi i votimit të përgjithshëm (universal), parimi i zgjedhjeve të lira, i barazisë së votës (fshehtësia dhe individualiteti), periodiciteti i zgjedhjeve mund vijojmë në rrugën evolutive të forcimit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Gjithashtu, duke mbajtur prasysh dhe *"detyrat e shtëpisë"* që Shqipëria është duke bërë lidhur me procesin për hapjen e negociatave, theks ishte vënë mbi fenomene të tilla negative si: blerja e votës, presioni ndaj votuesve etj. Se çfarë rëndësie vendimtare ka e drejta e votës, profesoresha e Departamentit të Politikave në Universitetin e San Franciskos, Ange-Marie Hancock i përmbledh në një mënyrë tepër origjinale:

1645 Një votë i dha Oliver Cromwell kontrollin e Anglisë;

1776 Një votë i dha SHBA-së gjuhën zyrtare angleze, në vend të asaj gjermane.

1868 Një votë e shpëtoi presidentin Andrew Jackson nga shkarkimi;

1876 Një votë solli ndryshimin e qeverisjes së Francës nga monarki në republikë.

1920 Gratë fituan të drejtën për të votuar me ndryshimin e amendamentit të 19 të

Kushtetutës. Shteti i fundit Tennessee që duhej të miratonte këtë amendament e ratifikoi atë përmes një vote.

1923 Një votë i dha Adolf Hitlerit udhëheqjen e partisë naziste;

1941 Një votë e shpëtoi Shërbimin e Rekrutimit, një javë përpara se Pearl Harbor të sulmohej.

1960 Kufiri i fitores së John F. Kennedy mbi Richard Nixon ishte më pak se një votë për zonë elektorale.

BIBLIOGRAFI

Akte Normative Ndërkombëtare

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948
- Karta Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 2000
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut 1950
- Konventa për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Gjnor, 1979.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike 1966

Akte Normative Kombëtare

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, miratuar me referendum më 22.11.1998, shpallur me dekret të Presidentit të Republikës me nr. 2260, datë. 28.11.1998 të Kuvendit Popullor, ndryshuar së fundmi me ligjin nr. 76/2016 nr. datë 22.07.2016
- Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, përditësuar me vendimin e GJK nr. 32, dt. 21.06.2010, Kodi Zgjedhor i RSH
- Ligj nr. 9970, datë 24.07.2008, "Për Barazinë Gjnore në Shoqëri"

Tekste, artikuj

- Alimehmeti, E & Merkuri (2012), E. *Konferenca shkencore Ndërkombëtare: Aspekte të ndryshme të sistemeve zgjedhore dhe roli i tyre në zhvillimin e demokracisë* "Rregullimi ndërkombëtar i të drejtës për të votuar në një perspektivë historike".

- Anastasi A. (2007) *Historia e të drejtës Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*. Tiranë: Pegi
- Anastasi A. (2010), *Të Drejtat e Gruas në Legjislacionin Shqiptar*, botim i OSBE Prezenca në Shqipëri, Tiranë.
- CRCA/DCI Shqipëri, (2012) *Mobilizimi dhe angazhimi i komunitetit për më shumë përgjegjshmëri nga vendimmarrësit*, Tiranë
- European Commission, (2018) *Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2018 Communication on EU Enlargement Policy (Albania 2018 Report)*, Strasbourg
- Whitefield S. & Shabani E. (2017) *Pengesat për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje në Shqipëri, Indeks Kombëtar i pjesëmarrjes së grave në zgjedhje përfshirë 12 rrethet*, Oxford University
- Instituti i Studimeve Politike. (2018) *"Parlamenti në pasqyrë - monitorim, analizë, problematika"*, Tiranë.
- Këshilli i Evropës, (2003) *Ushtrimi i të drejtave individuale të grave për të votuar - një domosdoshmëri demokratike*, Strasbourg
- Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombet e Bashkuara, (2017 – 2021) *Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm*.
- OSBE, Prezenca për Shqipërinë, *Fuqizim i grave në Politikë*, Tiranë
- OSBE/ODHIR, (2017) *Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve*, Tiranë
- OSCE OFFICE FOR DEMOCRATIC INSTITUTIONS AND HUMAN RIGHTS (2018) *Annual Report 2018*, Warsaw
- OSCE, Office of the Secretary General, (2014) *Gender Equality - Review Conference Report*, Viena

- Partnerët Shqipëri (2015) Studim mbi edukimin dhe motivimin e votuesve në prag të zgjedhjeve vendore të qershorit 2015 në Shqipëri, Tiranë
- Pasha A., Islami E., Dervishi J., Dodbiba P., Agalliu F. (2014), *Liria e Votës dhe Votimi Familjar në Shqipëri*, Botim i Institutit për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi – IDRA, Tiranë

Materiale nga interneti

- http://www.adawipartnership.org/Attachments/Voting_OneVote.htm
- <http://www.un.org.al/publications/pengesat-p%C3%ABr-pjes%C3%ABmarrjen-e-grave-n%C3%AB-zgjedhje-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-obstacles-women%E2%80%99s>
- <https://middletonma.gov/303/The-Power-of-One-Vote>
- https://www.coe.int/t/dgap/democracy/Activities/Key-Texts/03_Summaries_of_all_Publications/WomenIndividualVotingRights_alb.pdf
- https://www.idrainstitute.org/files/reports/un_women/Raporti%20Liria%20e%20Votes%20dhe%20Votimi%20Familjar.pdf
- <https://www.osce.org/sq/odihr/elections/albania/351226?download=true>
- [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20\(Final\).pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20(Final).pdf)